



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr. 75/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit N.SH “K...”, SH.P.K me seli në Obiliq, të cilin e përfaqëson N.H, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 15.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit N.SH “K...”, SH.P.K me numër KE.nr. 75/22 (C.nr 2898/16, 2019:203475) e datës 19.11.2015, me objekt kontesti kompensim dëmi, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi N.SH “Kastrioti”, SH.P.K me seli në Obiliq, të cilin e përfaqëson N.H, avokat nga Prishtina, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm me datën 19.11.2015 ka parashtruar padi për kompensim të dëmit kundër të paditurës Komuna e Obiliqit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas transferimit të kësaj lëndë, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka marr aktvendimin KE.nr. 75/22 të datës 31.10.2022 me të cilën e ka obliguar paditësin që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, të bëjë plotësimin dhe korrigjimin e padisë.

I autorizuari i paditësit, me datën 10.11.2022, me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se e tërheq padinë për shkak se kanë ndryshuar rrethanat dhe se kanë pushuar shkaqet që për të njëjtën të vendoset nga gjykata. I ka propozuar Gjykatës që jashtë seance të merr vendim dhe të lejoj tërheqjen e padisë.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së të autorizuarit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KE.nr. 75/22, datë 15.11.2022

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, bazuar në nenin 261 par. 4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.